



VENDIM

Nr. 5 Datë 17.01.2014

MBI

ANKANDIN E MUAJIT SHKURT 2014 TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma “ç”, paragrafi “ii”, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 7, gërma “b”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe Kapitullit X, pika 2, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.01.2014, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike,

Vendosi:

1. OST sh.a t'i alokojë me të drejta të siguruara pa pagese, shoqërisë KESH sh.a, kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin Shkurt 2014, në drejtim importi, për kryerjen e importit të energjisë elektrike, për furnizimin e konsumatorëve tariforë, duke pasur parasysh nevojën për kapacitet importues të pjesëmarrësve të tjerë të Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri.
2. OST sh.a., të zhvillojë ankand për muajin Shkurt 2014, për kapacitetet e mbetura ndërkufitare në drejtimin e importit, me qëllim plotësimin e nevojave për kapacitet importues të pjesëmarrësve të tjerë të Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri.
3. OST sh.a., të zhvillojë ankandin për muajin Shkurt 2014, për kapacitetet ndërkufitare me drejtim eksporti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Komisionereve



4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftoje OST sh.a., për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në fletoren zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI